



## PROCESVERBAL V/2023

### **I mbajtur me rastin e mbledhjes së 5 (pestë) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 31.05.2023  
Ora: 10.00

---

#### **Prezentë në takim:**

Z. Shefket Kolgeci  
Z.Selman Kolgeci  
Z. Flamur Bytyçi  
Z. Urim Suka  
Z. Kushtrim Kuçi  
Znj. Elmaze Bytyqi  
Znj. Bulëza Kuçi  
Znj.Doruntina Zenelaj  
Z.Alban Berisha  
Z. Bexhet Kuçi  
Z. Reshat Selimaj  
Z. Lirim Qatani  
Z. Aziz Bytyqi  
Znj.Sanie Kuçi-  
Rexhepaj  
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina  
Z. Vullnet Luzhnica  
Z. Xhevxhet Gashi  
Z.Edon Sadikaj  
Znj.Saranda  
Bajraktari  
Znj.Mimoza Bajraktari  
Znj.Festë Kabashi  
Z.Dardan Berisha  
Z.Bajram Basha  
Znj.Mevlude Kabashi  
Znj.Sheqerije Zyrapi  
Znj.Laureta Tafaj  
Z.Liridon Fandaj  
Z.Qëndrim Elshani  
Z.Herolind Limaj  
Znj.Jehona Rrafshi

#### **Të pranishëm të tjerë**

Kryetari i Komunës  
Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

### ***REND DITE***

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë” , “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-21225;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për faljen e borxheve të pa paguara;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 të barten për shfrytëzim në vitin 2023;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

**Dardan Berisha** - nëse ka mundësi propozoj që pika e 8-të të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

**Kryesuesi** - faktikisht e dyta sepse e para është procesverbali.

**Urim Suka** - a ka ndonjë arsytim?

**Dardan Berisha** - disa asambleistë kanë aktivitete dhe ndoshta edhe nuk mund të qëndrojnë deri në fund dhe besoj është shumë e rëndësishme.

**Urim Suka** - duke e vlerësuar secilën pikë,unë nuk mendoj që asambleistët kanë ndonjë angazhim më të madh se sa të rrinë në Asamble kur e kanë një here në muaj takimin dhe mendojmë që rendi i ditës duhet me qenë ashtu si ka ardhë si material.

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin që pika e 8-të e rendit të ditës të shqyrtohet si pikë e dytë e rendit të ditës dhe të tjerat të shkojnë me radhë.

**15 për, 11 kundër, 2 apstenime  
Miratohet propozimi**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**17 për, 2 kundër, 9 apstenime  
Miratohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - pasi nuk ka vërejtje kryesuesi e hedh në votim pikën 1.

## Unanimisht Miratohet

### Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;

**Qëndrim Elshani** - edhe ju e thatë që kjo rregullore ka ardhë para dy muajve dhe e njejta nuk është votu. E shikova por nuk është ndryshu asgjë prej herës së kalaur. Kjo rregullore një here nuk u votu dhe me u sjell prap në Kuvend pa asnjë ndryshim, më duket e pakuptimtë. Kjo rregullore u kundërshtu prej shumicës së asambleistëve për shkak të rritjes së çmimit. Me arsyetimin për rritje të pagave të punonjësve të Eko Regjionit është tentu edhe herën e kalaur të rritet tarifa prej 4.5 euro në 6 euro për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Kjo vetëm do ti rëndojë qytetarët e Komunës sepse kjo nuk po ndikon në cilësinë e shërbimit apo në rritjen e pagave të punëtorëve. Nëse rriten pagat e punëtorëve, atëherë ne po votojmë pro por nuk parashihet në këtë rregullore. Kjo shihet se po përgaditet me siguri për një operator ekonomikë privat i cili mund të konkuroj me një çmim edhe më të lirë dhe punëtorët e Eko Regjionit me shumë gjasë do të mbesin pa pagë. Ne si LVV e kemi kundërshtu këtë rritje herën e kaluar dhe e kundërshtojmë përsëri dhe ftojme të gjithë asambleistët që të bëjnë të njejtën gjë.

**Urim Suka** - çuditërisht ne detyrohemi që rregulloren e njejtë që e kemi diskutu tre muaj më parë ta diskutojmë prap dhe ta japim mendimin prap për të njejtën rregullore për të cilën nuk është ndryshu asnjë gjë por kanë ndryshu disa rrethana dhe rrethanat që kanë ndryshu janë në favor të asaj vote kundër që e kemi dhënë për faktin se tre muaj më parë qeverisja që është këtu thoshte që ka probleme, janë rrit shpenzimet, çmimet e naftës. Ne e dim që kjo kompani shumicën e shpenzimeve i ka nga derivatet e naftës ndërsa ne tash kur diskutojmë, këto çmime kanë fillu të zbriten dhe një argument plus që e kemi pas atëherë është më pak. Për neve, prurja në një diskutim pa e ndryshu asnjë fjalë të asaj rregullore është presion ndaj kuvendarëve, është shantazh ndaj kuvendarët sepse ata e kanë dhënë fajlën e vet për këtë rregullore. Ne e kemi diskutu edhe me qytetarë dhe qytetarët e kanë çdo ditë shqetësimin e rritjes së tarifës. Ju nuk po e rritni 1.50 € tarifën por ju po e rritni mbi 30 % tarifën. Nëse e garantoni dikush rritjen e pagave dhe na bje diçka me shkrim që kjo rregullore nëse rritet edhe tarifa, do të ketë ndikime dhe do të rriten pagat e punëtorëve kaq përqind, atëherë ndoshta do ta kemi një mendim tjetër por kjo nuk qëndron. Ne mendojmë që çmimi prej 4.50 € për ekonominë familjare duhet të qëndroj ashtu siq ka qenë ndërsa nëse ka nevojë dhe kjo kompani nuk mund ti mbuloj shpenzimet atëherë të rritet buxheti nga Komuna për mbështetje për kompaninë siq e ka pas një kontratë çdo vit me ta. Vota jonë për këtë rregullore do të jetë kundër për faktin që kjo që ju po bëni është një lloj presioni edhe ndaj kuvendarëve. Unë jam i interesuar ti shoh ata kuvendarë që e kanë ngrit dorën kundër herën e parë, me çfarë arsyeimi do ta ngrisin dorën sot. Unë ftoj secilin asambleist që para presionit të qeverisë lokale, ta mbaj anën e qytetarit.

**Laureta Tafaj** - të nderuar punëtor të Eko Regjionit dhe të gjithë të tjerët, e dime që këtu është duke ndodh një hajni para syve të të gjithëve. Pa një vendim në letër nuk mund të thuash që po rritet paga e një punëtori të Eko Regjionit. Nëse në një deponi u rrit për 2 € çmimi i tonit, atëherë ti po ia merr 1.50 € për një ton qytetarit por nuk mundet një familje me pas një ton mbeturina. Para dy muajsh kur ka qenë kjo pikë, Kryetari nuk ka qenë në seancë dhe kur nuk kaloi kjo pikë, ju patët then që ka me kalu kjo pikë. Si jeni përgadit për me kalu sot, ta shohim tash.

**Kryesuesi** - kuptojeni që rregullorja nuk e parash rritjen e pagave.

**Laureta Tafaj** - ju jeni thirr në rritjen e pagave të punëtorëve .

**Kryesuesi** - rregullorja nuk e parasheh. Është kërkesë e grupit punues që të rriten shërbimet.

**Saranda Bajraktari** - fillimisht dua ti them Urimit që nuk ka nevojë të na paragjykoj sepse mbi të gjitha ne jemi identitete personale që kemi të drejtën e votës. Personalisht jam kundër rritjes së çmimit dhe vota ime është kundër. Nuk jam kundër rritjes së pagave të punëtorëve mirëpo ju, na sillni ni aneks dokument ose kontratë që këto rritje shkojnë për paga të punëtorëve.

**Alban Berisha** - kisha pas dëshirë që sa here të silltet një rregullore, më mire të thuhet për miratim dhe jo për shqyrtim. Është mirë që grupi punues të na bëjë një elaborim të kësaj rregullore se çka do votojmë sepse nuk mjafton vetëm të na dërgoni me email por duhet të na jepni sqarime më shumë që ne ta dëgjojmë dhe ndoshta edhe na bindni që me votu pro. Kam disa pyetje rreth rregullores. Si mundet në të

njejtën kategori me u klasifiku një kompani e sigurimeve, frizer ose një librari me një vullkanizer ose automekanik? Si Drejtori e Shërbimeve Publike, a e keni shiku ndonjëherë se çka bëjnë automekanikët me mbeturina? Sa derivate, sa vaj i djegur dhe si bëhet ajo lagje kur është aty një automekanik? Respekt për punën e tyre por ne po flasim për menaxhimin e mbeturinave dhe tash një librari është në të njejtën kategori me një automekanik. Këtu janë edhe bastoret dhe kazinot. Ku janë ato? A po flisni për ato që veprojnë ilegalisht apo u hap ndonjë që se kam pa, apo është vetëm një shabllon, ndërtoni datat dhe e sillni në Asamble, e që për mua është fyerje që na sjellni neve me votu diçka për kazino duke e ditë që Kryetari jonë e mban bajrakun dhe thotë që unë jam iniciatori që e mbyll këtu e që ne e kemi përkrah dhe vërtetë u nis prej Suharekës me u mbyll. Tash, prej Suharekës do të nis me rregullore me u zyryarizu që po ekzistojnë! A ka mundësi të na jepni sqarime se pse po ndodh kjo?

**Enver Shabani** - Alban, pyetja jote është me vend. Për grupin punues ka qenë një vendim i cili është nënshkru nga Kryetari dhe në grupin punues kanë qenë dhe anëtarë nga secila parti. Pas grupit punues, me pëlqimin e agjencisë japoneze, ata kanë përzgjedh një zyre ligjore e cila e ka punu rregulloren. Zyra ligjore e paguar nga gjajka e cila e ka marrë për sipër menaxhimin e mbeturinave dhe na asiston 5 vitet e fundit në menaxhimin e mbeturinave. Suhareka është njëra nga vendet më të mira dhe më të pastra sa i përket menaxhimit, grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave. Sa i përket tarifave, mund ta cilësojmë si lëshim teknik për bastore dhe kazino por nuk do të thotë që një të ardhme nuk do të hapen, por ato kanë mbet. Nëse nuk ka çka të inkasohet, ai nuk shkon të inkasoj diçka që nuk ekziston por nëse ka, e bën edhe inkasimin e atyre. Nëse sot kalon si pikë, ne bëhemi Komuna e 8-të në Kosovë që ngrit tarifën nga 4.5 € në 6 € dhe arsyeja nuk është vetëm ngritja e pagave. Ne si Komunë e kemi vetëm një anëtar në bord, ku ai anëtar do ta ngris si një ndër problemet edhe ngritjen e pagave sepse siç e dini para ca ditësh ka pas protestë të punëtorëve ku e patë se çfarë kaosi u bë dy-tre ditë. Andaj ju bëj thirrje ta votoni sepse është në të mirën e qytetarëve. Drejtori tutje jep sqarime.

**Alban Berisha** - unë mendoj që kolegët e mi e morën përgjigjen sepse unë nuk e ngrita pyetjen për tarifa. Respekt për punën që e ka bë studio ligjore. Nuk mendoj që ka qenë ndonjë akt por e kanë sponsorizu japonezët dhe faleminderit prej tyre. Pavarësisht kush e punon, e miratuar është prej neve, Asamblesë. Mua më intereson të di se a është e drejtë që një kompani e sigurimeve ose një frizer i barabartë me një automekanik? Ju si drejtori a jeni në ngjarje dhe a e përcjell punën e atomekanikëve në ndotjen e ambientit dhe menaxhimin e mbeturinave të tyre?

**Enver Shabani** - përveq zyrës ligjore që e përgadit rregulloren, instruksionet kanë shku nga grupi punues dhe nga terrenet.

**Alban Berisha** - a është në rregull apo s'është në rregull?

**Enver Shabani** - grupi punues dhe zyra ligjore e kanë parapa që është në rregull. P.sh. Eko Regjioni mekanikut nuk ia merr gomat. Gomat shkojnë në riciklim sepse ka deponi të veqanta për goma.

**Selman Kolgeci** - Kryetari siç është taku me punëtorët e Eko regjionit, jemi taku edhe ne në kohën kur ata kanë qenë në grevë. Atyre u është premtu që ka me iu rrit paga në seancën e ardhshme të Kuvendit. A është ngrit në grevë kompania apo janë ngrit në grevë punëtorët? E di që janë ngrit në grevë punëtorët dhe i kuptoj që kanë të drejtë të kërkojnë një page të dinjitetshme dhe uroj që t'i plotësohet kjo. Por në planin komunal për menaxhimin e mbeturinave në asnjërin pikë nuk keni thënë që po kërkonit rritjen e çmimit të shërbimit me qëllim të rritjes së pagave të punonjësve. Ju për këtë rritje të çmimit jeni arsyeju me rritje të çmimit të derivateve të naftës dhe çmimit të deponisë. Sot jemi në një realitet tjetër, sot e kemi naftën më lirë se para pesë viteve. Nuk po e kuptoj si ka mundësi me iu ngrit pagat punëtorëve duke e ngrit 1.50 € për familjet. Kush na siguron që kanë me iu ngrit pagat punëtorëve? Unë dëshiroj që gjithë punëtorëve të sektorit privat t'ju ngritet paga për faktin se jemi duke jetu në një realitet që duke ik çdo ditë, rini, moshë e mesme dhe moshë e vjetër. Kjo nuk rregullohet kështu.

**Laureta Tafaj** - fillimisht ne nuk jemi të sigurt që pas një kohe ose pas një viti ka me marrë Eko Regjioni përsëri menaxhimin apo ka me marrë ndonjë kompani tjetër private. Drejtori i Shërbimeve Publike tha për paga të punëtorëve, dhe Kryesuesi tha që jo për paga të punëtorëve. Ju lutem, ta gjejmë një mes dhe le të na kuptojnë edhe ata që po na dëgjojnë tani.

**Saranda Bajraktari** - pyetje për Drejtorin. A mundeni ju ose ne si Komunë me i rrit aksionet në Eko Regjion që me pas rritje të pagave të punëtorëve? A ekziston rregullore ose ligj?

**Enver Shabani** - Lauretë, është njëra nga arsyet por ne nuk e bëjmë organizimin e ngritjes së pagave. E kemi një përfaqësues në bord i cili do ta ngris zërin për me iu ngrit pagat e punëtorëve dhe vota e tij ka peshë, por ndonjë vendim me shkrim nuk mund t'ia japim. Sa i përket pyetjes së asambleistes Bajraktari, kjo veq është ngrit në një formë por nuk kemi bërë ndonjë analizë tjetër. Drejtori tutje jep sqarime.

**Flamur Bytyçi** - gjithë ky debat po bëhet me arsye të mëdhaja, po rritet një tarifë për qytetarë, po rëndohet ekonomia familjare. Aq sa kam analizu, kjo kompani ka operu me humbje. The që e kemi një aksionar. Ne nuk e kemi pa asnjë raport të një aksionari. A ka pas iniciativë që ne si Komunë me themelu një ndërmarrje dhe vet me menaxhu? Dua të di, kush është përfaqësuesi jonë në Eko Regjion?

**Enver Shabani** - përfaqësuesi jonë në Eko regjion është Jeton Sallauka por nga Asambleja dhe nga zyra e Kryetarit është caktu edhe komisioni për mbikqyrjen e Eko Regjionit. Herën e kaluar kam qenë unë në komision, Dardan Berisha, Gazmend Gashi dhe të tjerë. Punën e mbikqyrin dhe raportojnë çdo muaj për të hyrat dhe shpenzimet që kanë ata. Ka më shumë se një vit që ne kemi bërë kërkesë në ministrinë për Ambient që t'na lejojnë në krijimin e ndërmarrjes publike lokale komunale ku menaxhohet drejt për së drejti nga Komuna por jo vetëm për mbeturina por edhe për disa punë të vogla që s'mund ti kryejnë kompanitë e mëdhaja. P.sh. pusetat, shenjat e komunikacionit që po rrëzohen, krasitjen e pemëve e të tjera. Nëse na lejojnë atëherë ne kemi me qen edhe më mire se sot dhe atëherë mund t'ja garantojmë qytetarit dhe juve që ngritja e pagave bëhet drejt për së drejti nga Komuna.

**Flamur Bytyçi** - unë këtu po e shoh problemin më të madh se ne nuk mund ti garantojmë punëtorëve të ndërmarrjes që ne kemi me ja rrit rrogën dhe ashtu po e transmetoni edhe ju. Unë kërkoj nga ju që ju, të shkëputeni prej Eko Regjionit dhe ta themeloni një ndërmarrje publike të cilën e menaxhon Komuna e Suharekës.

**Kushtrim Kuçi** - unë kam qenë pjesë e grupit punues prej LDK-së. Në takimin që kemi mbajtë në fillim, përfaqësuesi i Eko Regjionit ka pas dy kërkesa kryesore gjatë gjithë kohës të cilat i ka potencu në takime. Kërkesa e tij e parë ka qenë ngritja e naftës në atë kohë që sot nuk po qëndron dhe arsyetimi i tij i dytë dhe kryesori ka qenë ngritja e rrogës për secilin punonjës dhe ne jemi pro kësaj. Për deri sa sot asnjëra nuk po qëndron dhe ne vetëm po e rrisim çmimin për qytetarë atëherë, sa do të ketë efekt kjo? Drejtori e cekti që ne i kemi dorëzë 1200 kontinier dhe është shumë mirë. Shyqyr buxheti i Komunës ka para. Por mos me dal me ato kontinier e ato fotografi, çka bëni me ato pare? Sepse po iu merr Prishtina. Kështu që, më mire ti jepni këto kontinier e të bëni fotografi sepse kurrfar efekti s'po ka.

**Enver Shabani** - asnjë cent nga buxheti i Komunës nuk ka shku për kontinier. Kanë qenë grande të performancës, të punës së mirë.

**Selman Kolgeci** - Drejtor, nëse ngritet sot prej 4.50 në 6 € ashtu si ka ardhë me u ngritë me premtim dhe komopania nuk ia rrit pagat punëtorëve, ata dalin nesër prap në grevë. A do të vini të kërkon prap edhe 1.50€ tjetër? Unë mendoj që nuk duhet me i ngarku qytetarët me 1.50€ për familjet.

**Enver Shabani** - nuk ka ardhë rregullorja sot pse ata kanë bë protestë. Pothuaj gati një vit jemi duke punu në këtë rregullore dhe për këto tarifa. Thashë nuk është vetëm ndonjëra nga arsyet nafta ose rroga por që nga 2010-ta nuk ka pas ngritje të tarifës dhe ju e dini sa kanë lëviz çmimet. Unë nuk garantoj për rroga por ka me u ngrit rroga sepse është arsyeja e vetme për me kriju të hyra dhe me u rrit rroga.

**Reshat Selimaj** - në vitin 2009 Kryetar ka qenë z. Blerim Kuçi dhe Nënkyetar z. Bali Muharremaj. Këtë plan të grumbullimit të mbeturinave e kemi ekzekutu më duket për here të pare fshatin Grekoc ku ka qenë 4.50€ dhe disa thasë për familje. Kemi ardhë me vetëdëshirë dhe kemi thënë që nuk na duhen thasë por vetëm le të bëhet grumbullimi i bërlllogut. Alban, nga ai vit deri më sot, a e din ndonjë kategori që nuk është rrit? Flamur, nëse e lëmë 4.50€, asnjë cent nuk ke me mujt me arrit dhe nëse ne e bëjmë 5€, atëherë është 30 % si u tha dhe me 30% të rritjes unë jam i sigurt që diçka do të përfitojnë punëtorët. Ne secili i hargjojmë 5 € në ditë dhe kërkoj ta votoni sepse nuk është kosto e madhe.

**Urim Suka** - çështja është se ne këtu kemi dy zëra. Kur po flet drejtori, po flet në tjetër gjuhë por tash po flasim në këtë gjuhë sepse po doni ta bëni punën me kalu si rregullore. Dhe zëri tjetër është që kur iu kanë dasht Kryetarit votat, në mandatin e parë ka shku dhe ju ka thënë punëtorëve që rrogën do t'ju bëj 700€ dhe tash ju ka thënë që rregullorja ka me shku në Asamble dhe rrogat do të rriten 50€. Këto informata janë

prej punëtorëve. Hajde ta kthejmë në nivel serioz cilëndo rregullore dhe cilëndo vendim dhe kur e kthejmë në nivel serioz edhe ne e sjellim me qasje serioze.

**Kryesuesi** - ne jemi duke bisedu për një rregullore të punës që Kryetari nuk ka qasje në grupin punës-rregullues. Është grupi i ekspertëve që e kanë sjellë këtë rregullore. Në rregullore askund nuk shkruan që ka rritje të pagave.

**Urim Suka** - unë e di. Kryetari kur ka premtu është desh ta dijë që në rregullore nuk shkruan. Mos provoni me bënë një lloj presioni te ne se ju s'po doni me ja rrit rrogat. Sillne një vendim të atij bordi që 30 % po rritet inkasimi, 30% kanë me u rrit pagat dhe ne ndoshta kemi vendim tjetër.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - pyetja ime është për drejtorin Enver pasi përmendi faktin që në mandatin e kaluar ka qenë pjesë e komisionit të aksionerëve të Eko regjionit. Tani jam vet pjesë e këtij komisioni por që 1 vit e gjysëm anëari i bordit nuk ka raportu te ky komision, deri sa këtë muaj kam marrë iniciativ me u mbledh komisioni konkretisht për këtë rregullore. Duke marrë parasysh që kjo rregullore nuk është konsultu në asnjë moment me komisionin e aksionerëve, unë për këtë pikë të rendit të ditës do të apstenoj.

**Alban Berisha** - Reshat, asnjëherë nuk e kam përmend rritjen e çmimit që jam kundër. Nuk them që jam pro si ti dhe si drejtori më jepni arsyttime pse duhet me rrit çmimin kur unë nuk thashë pse me rrit dhe as pse mos me rrit çmimin. Për gjuhën e biznesit që the, unë deri sa të hy këtu, unë mund të jem njeri që merrem me biznes, me sport por edhe me fusha tjera por kur të hy këtu, unë jam asamblesit sikur të tjerët. The që janë rrit çmimet. Krahas rritjes së çmimeve tjera janë rrit edhe çmimet e biletave të autobusave. A e ke bënë ndonjë kërkesë, rregullore për me ngrit çmimin ose për inkasimin e të hyrave aty? A janë çmimet e njejtë siç kanë qenë apo i keni ngrit çmimet?

**Reshat Selimaj** - ti e din që aty nuk ka pas bord për 6 muaj. Kjo analizë është bërë rreth pesë here. Ju po bëni politikë me disa gjëra që s'bën të bëhet politikë. Unë të pyes: kategoritë tjera a janë rrit? si: tatimi në pronë, rryma. Ku është reagimi yt? Edhe kjo duhet të rritet.

**Flamur Bytyçi** - fokusi im më shumë ishte që si me u shpëput ne prej Eko regjionit dhe me themelimi një ndërmarrje vet, me menaxhu vet dhe atëherë jo vetëm 6 € por edhe 10 € me sjell, unë e kisha përkrah. Arsyetimi tjetër është se unë nuk mund ti besoj një ndërmarrje që ka operu 13 vjet dhe ka keqmenaxhu.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - unë i bëra një pyetje drejtorit dhe nuk mora përgjigje. Si ka funksionu mandatin e kaluar?

**Enver Shabani** - mandatin e kaluar ne jemi takuar minimalisht një here në muaj. Ka raportuar Jetoni dhe i kemi dosjet, raportet e të gjitha. Nuk kemi pas telashe. Ka pas kohë pas kohe ankesa të veta dhe ne jemi mundu ti mbështesim. Drejtori tutje jep sqarime.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - atëherë po e pyes zyrtarin ligjor për shkak se këtu diçka nuk funksionon për deri sa ne ka 1 vit e gjysmë që nuk jemi organizu si komision. Kush duhet me ftu këtë komision ose kush raporton te ky komision?

**Enver Shabani** - kush është kryesues i komisionit është mire ti ftoj dhe ta njoftojë anëtarin e bordit. Sa here e kemi ftu anëtarin e bordit, asnjëherës'ka mungu dhe na ka dhënë informata të mjaftueshme.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - gjithësesi ne kemi insistu me mbajtje një takim me drejtorin Enver por që për arsytet e tij nuk ka qenë pjesë e takimit. Në takimin e radhës që do të mbajmë, e kemi ftuar zyrtarin ligjor por për deri sa komisioni i aksionarëve është neglizhu në hartim të kësaj rregullore atëherë unë si anëtare e atij komisioni do të apstenoj për këtë pikë.

**Enver Shabani** - nuk ju kemi neglizhu. Kur është formu komisioni ju nuk keni qenë anëtarë të komisionit atëherë. Vendimi kur është marrë për grupin punës ka qenë në vitin 2021 apo 2022.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - kjo rregullore është hartu dhe nuk është mbajtje asnjë diskutim publik. Para dy viteve nëse është formu grupi punës, ne para një viti e gjys jemi formu si komision, kështu që keni qenë në faza hartuese dhe ka qenë e rrugës të na informoni që është duke u hartu kjo rregullore.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**13 për, 15 kundër, 2 apstënim  
Nuk miratohet Pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen "Qytetar Nderi" i Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

#### **Unanimisht Miratohet**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Shefket Kolgeci** - unë shumicën prej tyre po i njoh por unë kisha kërku të na prezantoni një biografi të shkurtër për këta individ.

**Kryesuesi** - faktikisht biografia u sjell për secilin kandidat por për Shefki Muqën nuk e kam me vete sepse ne si komision e kemi diskutu dhe anëtarë të komisionit jemi prej të gjitha subjekteve politike.

**Shefket Kolgeci** - arsyeja pse e bëra këtë pyetje ishte pikërisht për Shefki Muqën sepse Shefki Muqa është i Vraniqit por ka jetu në Suharekë dhe do të ishte mirë edhe biografia.

**Kryesuesi** - lexon biografinë e Shefki Muqës.

**Shefket Kolgeci** - unë e përkrahi këtë iniciativ por biografia është që qytetarët të dinë më shumë. Nuk jeni përgadit sa duhet dhe i keni rënë shkurt. Shefki Muqa ka lind në Vraniq të Suharekës dhe aktiviteti i tij me të vërtetë ka qenë i bujshëm dhe meriton këtë deklaratë dhe mos të flasim për ata të Maqedonisë që kanë dhënë jetën këtu te ne.

**Kryesuesi** - shpërblimi “Skënderbeu” i ndahet dëshmorit, Nysret Baftjar Gashi. Është vlarë në vitin 1989. Presidentja e ka shpall dëshmor.

**Jehona Rrafshi** - gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, si pjesë e komisionit, ne jemi dakordu që ka pas mangësi të disa dokumenteve të propozimeve. Nuk jam kundër dhe pa dushim do ta votoj por dua ta kem të qartë se a janë plotësuar të gjitha dokumentet e nevojshme.

**Kryesuesi** - po, i kemi bërë thirrje dhe janë plotësuar të gjitha dhe i kemi në dosje.

**Dardan Berisha** - edhe ne si grup i PDK-së jemi pro këtij vendimi. Vet fakti që për këta njerëz tregon historia, veprat, dokumentarët, nuk ma merr mendja që ne duhet me kërku dokumenta shtesë sepse s’është me rëndësi kush ka qenë por me rëndësi është që për këta njerëz po tregojnë veprat.

**Jehona Rrafshi** - dokumentat shtesë janë kërku në bazë të rregullores dhe nuk kemi kërku dokumenta shtesë jashtë rregullores që është paraparë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

#### **Unanimisht Miratohet**

**Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhësuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin. Nuk ka debat, Kryesuesi e hedh në votim pikën 5.

#### **Unanimisht Miratohet**

**Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-21225;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Laureta Tafaj** - ndonjëherë duhet me dëgju opozitën. Herën e kaluar unë e kundërshtova këtë vendim dhe kësaj here ka ardhë me u shfuqizu.

**Selamn Kolgeci** - lidhur me këtë pikë shprehim keqardhjen tonë për gjithë qytetarët tonë në Shirokë që janë besimtarë të besimit islam dhe nuk kanë mindësi që ritualet e tyre ti kryejnë në lokalitetin ku jetojnë por duhet të shkojnë në xhamitë tjera. E tëra kjo si një pasojë e një planifikimi hapsinor që synim kryesor nuk kishte gjithëpërfshirjen dhe trajtimin e barabartë por qëllim kryesor ka qenë trajtimi i zonave me interes për grupin që e rrethon qeverisjen komunale në Suharekë. Kjo është një prej nëntë ankesave dhe

vërejtjeve për të cilat në kohën kur është miratu HZK-ja u kam kërku gjithë kolegëve që të shtyhet afati i shqyrtimit publik të hartës zonale dhe këtë propozim si shumë propozime tjera ju e keni kundërshtuar. Tani keni fillu me zënë thu në të por padyshim që qytetarët e pësojnë këtë arrogancë të numrave që një herë për një herë i keni në Kuvend. Në seancën kur është marrë ky vendim kemi kërku sqarime, se ndërtimi i objektit të xhamisë në atë parcellë a është në harmoni HZK-në aktive. Të tre akterët kanë thënë që po është në harmoni me të njëjtën dhe kur ju pyesim diçka, ju lutem bëhuni të sigurtë dhe tregoni të vërtetën. Ky planifikim hapsinor i mirë apo i keq është plan që e keni përpiluar ju, është plan që po tentoni me shkel ju, i mirë apo i keq zbatohet si e keni miratu e mos na nxirrni para aktit të kryer. Propozoj që Drejtori për Pronë dhe Kataster së bashku me stafin e drejtorisë së Urbanizmit, përfaqësuesit e bashkësisë islame, përfaqësuesit e fshatit Shirokë dhe pse jo edhe ndonjë anëtar i Kuvendit ti shohin mundësitë se a ekziston ndonjë pronë publike në Shirokë në të cilën e lejon harta zonale që të ndërtohet xhamia dhe të plotësohen kërkesat e banorëve atje.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 6 për shfuqizimin e vendimit.

### Unanimisht Miratohet

#### **Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për faljen e borxheve të pa paguara;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - edhe ky projekt-vendim që ka ardhë për faljen e borgjeve sikur shumë vendime që ju po hartoni e po na sillni tregon një qasje tepër jo serioze që ju keni ndaj Kuvendit, ndaj vendimeve që ju vet merrni e sidomos ndaj kuvendarëve. Në KPF kam kërkuar që t'na vijë një raport detal dhe ne si kuvendar për deri sa po detyrohemi me votu, ta dime detajisht se cilave klube po ia falim borgjet. Një raport ju e keni sjell ku tregon për stërvitjet e të tjera po askund nuk shihet se kujt po ia falim këto borgje. Vendimet që ne marrim, ne duhet me qenë krenar dhe në qoftëse aty duhet me fshah diçka, atëherë pse i marrim ato vendime? Dua sqarim nga ju se pse nuk na ka ardhë një raport detal që ne ta dime se për çka ta ngrisim dorën. A ka tjerë që kanë pagu? Në qoftëse ka klube apo persona që e kanë shfrytëzuar palestrën dhe e kanë bërë pagesën dhe tash ne këtyre që s'kanë pagu e marrim vendimin për me ia fal. Paradoksi është që ne i favorizojmë borgjilinjët dhe i ndëshkojmë ata që nuk kanë pagu. Kjo është e pa drejtë dhe e çuditshme. Për me qenë i drejtë ky vendim është dasht me qenë ai raport dhe është dasht me ditë kush ka pagu. Ata që kanë pagu ti bëjmë pak të barabartë me këta që s'kanë pagu dhe që po ia falim dhe t'ju themi që ju prej 2023-tës deri në 2030-tën e keni pa pare. Këtu diçka nuk ka funksionu. Pse mu mbledh gjithë ky borgj? A janë tarifatat e shtrenjta? Nëse janë të shtrenjta, ti lirojmë dhe nëse po duhet mi fal, ta heqim gjithë atë tarif. Për të na ndihmuar neve, që ne me votu këtë vendim, pse nuk është raporti dhe pse po e fshehni? Çka ka ndodh me ata që kanë pagu dhe a mund ti stimulojmë? Ta plotësojmë këtë vendim me një nen ku themi: ata që kanë pagu do ti stimulojmë për një periudhë të caktuar që të mos paguajnë më. Nëse kjo rregullore është e keqe, sillne ta shfuqizojmë ose ti ulim tarifatat dhe le ti përballojnë dhe ti paguajnë. Ndalni gabimet, ne flasim më pak. Bëhuni serioz dhe ne jemi shumë më serioz dhe i votojmë të gjitha ato që duhet të votohen siç i votuam edhe sot.

**Laureta Tafaj** - këto klube, a po i bie që po i favorizojmë nga dy here, një here me falje të borgjeve dhe një here me subvencione? Është e pa drejtë është me qenë anonim. Të paktën ta shohim një letër se kush janë ata, se pse s'po paguajnë dhe ne e votojmë dhe ia falim.

**Reshat Selimaj** - për ty është mandati i parë në Asamble dhe për të dytën sun e fiton sepse me këtë logjik kështu nuk fitohet. Dr. Shefqeti e din që ne kemi falë borgje kaherë, edhe në pushtetin tuaj. Mua personalisht më janë fal 8 mijë € si kompani. Këto borxhe janë nga 2010-ta. Të sugjeroj që, nëse nuk je për ti përkrah ato klube, mos bëj selfi me kampiona.

**Urim Suka** - nuk më intereson a e fitoj apo jo mandatin e dytë sepse dua ta përmbyll këtë mandat ashtu sikurse jam zotu te secili votues që kam shku t'ia kërkoj votën. Këto borgje nuk janë nga sot dhe as që thashë që janë nga sot. As nuk po them që s'do ti votoj por do ti votoj dhe po dua që vendimin të më bëj krenar dhe dua ta plotësoj atë vendim që ti se ke bërë si duhet. Unë kam bërë selfi edhe kur ka qenë Ballkani



në ligën e parë. Unë sportin dhe Ballkanin e dua, sikur është në lig të parë, si kur është në super ligë dhe sikur është kampion ose humbës.

**Elmaze Bytyqi** - me rastin e faljes së borgjit nga ana e Komunës, a është menduar që të rikuporehen të hyrat e planifikuara?

**Kryesuesi** - nuk ka këtu planifikime buxhetore.

**Dardan Berisha** - Urimi tha që në parim duhet me votu. Realisht që duhet me votu sepse këto borgje janë prej 2010-tës deri më 2017, këtij i takojnë. Nëse po bën dikush politikë, i vetmi njeri që po bën politikë në këtë Kuvend është Urim Suka. Gjithësesi nuk ma merr mendja që janë koefidenciale pagesat, stërvitjet dhe duhet ta dime edhe ne se kujt po ia falim dhe është shumë reale. Vetëm stërvitjet janë 128 mijë €, lojrat janë 53.700 € duke llogaritur edhe lojrat që kanë luajtur edhe disa klube jashtë që janë 2.250 €, d.m.th 55.950 €, te reklamat 61.200 €, të tjera 3.000 € dhe te këto 3.000 logjikisht e pashë që janë të subjekteve politike. Në total janë 248.185 €. Janë disa klube private që iu marrin nxënësve të holla për ta ushtruar aktivitetin sportive dhe tash ne po duhet t'ia falim edhe atyre sepse ata nuk e kryejnë obligimin. Ne në parim jemi pro por mos po krijohet standart pastaj. Duhet të keni parasysh për vitet që vijnë dhe pak ti kushtoni rëndësi. Ne gjithësesi jemi pro këtij vendimin.

**Kryesuesi** - ne jemi krenar me klubet tona dhe ne duhet ti përkrahim këto klube.

**Urim Suka** - tha që Urimi po bën politikë dhe shantazh. Po, jam duke bërë politikë dhe e pranoj por kurrë nuk jam duke bërë shantazh dhe kurrë në jetë s'kam bërë shantazh dhe kurrë në jetë s'ka për të bërë shantazh. Kurrë në logjikën e LDK-së nuk ka qenë që të bëj shantazh dhe kurrë s'do të bëj LDK shantazh.

**Dardan Berisha** - a është shantazh nëse se përmend vitin 2010 deri në 2017? A është shantazh me ju thënë asambleistave të mos e votojnë?

**Shefket Kolgeci** - në bazë të diskutimeve që dëgjova, nuk ishte asnjëri që nuk do ti fali këto borgje. Ne ngapak po bëjmë politikë shkaku me refuzo njëri tjerin. Andaj grupi jonë kërkon që të vijë një listë e të gjithë atyre që kanë borgje, një listë të atyre që i kanë kryer obligimet sepse edhe ne jemi për t'ia fal borgjet, edhe ne jemi për sport dhe mburremi për klubet tonë por ta dijmë arsyen se kujt po i falim dhe pse. Absolutisht ne do ti falim dhe nëse është aq urgjente sot me i kry, ne në momentin që do ta sillni atë listë do ta votojmë, por jo sot dhe jo me këtë qasje.

**Flamur Bytyqi** - u fokusova te vendimi dhe mu duk shumë amator duke e ditë që ky vendim do të kthehet mbrapsht prej qeverisë. Besoj Drejtoresha e din dhe a është në gjendje me marrë përgjegjësi për këtë vendim që do të kthehet mbrapsht? Pashë që nuk je bazu askund në këtë vendim që ke të drejtë me fal borgje. Besoj që Avniu duhet të na jep sqarime. Mendoj që ne duhet ta shohim listen se prej cilave vite po falim dhe mos jemi duke fal borgjin dy herë. Sa vite ka ky borgj që është i akumuluar? 300.000 € janë nda subvencione për këtë çështje dhe ju si Drejtoreshë keni mund ta diskutoni me ta kur janë nda subvencionet. Ju besoj që nuk keni me gjet dhe nuk keni mbështetje ligjore për me fal këtë borgj. A do të marrësh përgjegjësi nëse ky vendim kthehet mbrapa? Mbi 13 vendime i keni si qeverisje komunale që janë kthyer mbrapa. Besoj që ka ardhë koha me marrë dikush përgjegjësi se pse po kthehen këto vendime. Ne nuk jemi për mos t'ia fal, jemi për t'i ndihmuar dhe me dhënë subvencione por të njejtën kohë duhet me kry obligim. Çka do t'i thoni atyre që kanë pagu? Janë fëmijët që i paguajnë klubet, janë reklamat brenda dhe a paguajnë ata për këtë?

**Dardan Berisha** - te çështja e reklamës janë 61.000 € borgj. A janë largu ato reklama apo ekzistojnë ende? Nëse ai nuk paguan, pse e le reklamën? Merre dhe heqja reklamën nëse nuk paguan.

**Alban Berisha** - kisha pas dëshirë që për palestrën 13 Qershori të bëhet një rregullore e re për organizimin e këtyre çështjeve që të jetë më qartë e precizuar sepse ne kemi edhe klube sportive që janë me statusin e OJQ-së dhe disa i kemi me status të bizneseve private dhe ia lejon ligji. Të gjitha klubeve që janë të liqencuara edhe për ne si Komunë duhet me qenë e rëndësishme që ajo që e ka liqencën, për neve është zyrtarisht klub. Kisha mendu që në një të ardhme të afërt ta bëni një rregullore që mos me ardhë në një situatë që prap mi fal borgjet sepse edhe për opinionin publik është e pakapshme për disa vendime që merren këtu se si po falen gjithë këto para. Psh. kur janë fal në kohë të pandemisë edhe para pandemisë. Është një situatë e vështirë edhe për ne asambleista me marrë një vendim për ti fal dikujt borgji kur është dikush që ka pagu. D.m.th. gjithmonë bëhen precedente të këqija këtu që i udhëzon disa përfitues që mos me pagu sepse në një të ardhme kanë m'u fal prapë dhe vim prap në situatë të tillë. Në

konsultim me Drejtorinë e Financave, Kryetari si zyrtari më i lartë administrativ mundet me vullnet të mirë me rregullu këtë punë. Kur ne e miratojmë një subvencion rreth 80.000 € për “pushime në Anatalia”, çka do të ishte ta bëjmë një subvencion për t’i paguar shpenzimet e palestrës ose me funksionu palestra shumë më mirë pa pas nevojë për disa të hyra. Kur e thashë pushimeve, e di që ka me marrë prej dikuj një konutacion tjetër dhe unë e di që janë seanca stërvitore por mund të bëjmë edhe subvencione të llojit të tillë dhe me rregullu edhe punën e reklamave. Nëse ne sponsorizuesit mirremi vesh me një klub në bazë të ligjit për sponsorizime direkt me klubin, ai nuk e din mënyrën e funksionimit se a duhet ti paguaj klubit apo palestrës. Në këto raste kemi edhe diskriminime. Nëse dikush ka sponsorizim për volejbollin, reklamat janë statike që ai ka me shfrytëzuar hapsirën edhe kur të luan klubi tjetër që nuk ka sponsor. Drejtoresh, nuk është esenca vetëm me zgjidh një problem tash se a po ja falim borgjet apo s’po ja falim sepse dikush voton pro e dikush kundra dhe kur të dalim jashtë, të thërrasin e të thonë se pse se votove sepse dikush ka pas interes ose nëse voton pro, të thonë se pse votove. Pse? Sepse situata është e tillë. Tash ka ardhë dhe po e zgjidhim këtë problem por për të ardhmen mos të vje një vendim i llojit të tillë. E di që njëri prej kolegëve do të thotë që ka qenë keq edhe atëherë. Edhe unë them që ka qenë edhe atëherë keq, edhe kur ka qenë partia ime. Të bëhemi bashkë dhe ta rregullojmë këtë punë që mos të vijë më situata të tilla.

**Kryesuesi** - Alban, Drejtoresha ka faj më së paku sepse ky borgj është prej 1 janar 2010. Nëse rastësisht e ke reklamën aty, mos është konflikt interesi të votosh pro ose kundër?

**Alban Berisha** - Kam vërejtje. Kërkoj prej teje Kryesues dhe prej kolegëve që të jetë hera e fundit që përmendet biznesi në Asamble. Nuk bie në kundërshtim dhe po ndihem i fyer. Nuk jam këtu si biznesmen por jam si asambleist që kamë ardhë me vota të qyetetarëve .

**Lorika Gashi** - e kemi fillu si drejtori plotësim-ndryshimin e rregulloreve të brendshme. Fillimisht kemi fillu me bibliotekën, gjithëashtu jemi në proces të plotësim-ndryshimit të rregullores së subvencioneve. Për palestër jemi dhe për deri sa ka fillu puna në ndryshimin e rregullores së tarif ngarkesave atëherë unë nuk mund të bëj ndryshim në atë rregullore nëse unë kam borgj të akumuluar. Unë do të gjej zgjidhje për atë borgj i cili është nga 1 janari i 2010-tës dhe pastaj do të vendosi tarifa të reja dhe do të krijoj një qasje të re sepse e dime që ka shumë klube private, shkolla private, SHPK, OJQ, ka parti politike të cilat e kanë shfrytëzuar. Është rregullorja publike me shifra për secilin aktivitet sa duhet të paguaj. Ka reklama dhe janë edhe sot. Palestrën e shfrytëzojnë të gjitha klubet dhe pse nuk e kam bërë një raport me emra dhe mbiemra është se janë 10 libra protokollit në të cilat janë çdo ditë të shënuara ora, koha dhe përfundimi i stërvitjes.

Në vitin 2013 vetëm dy klube e kanë pagu palestrën sepse në atë kohë Drejtorja e Kulturës ka fillu me fut n’fukcion këtë rregullore mirëpo të gjitha klubet i kanë ndal aktivitetet dhe gjithë fëmijët tonë kanë mbetur rrugëve. Pse? Sepse s’kanë pas si ti paguajnë. Sepse është 50 € ora e një lojë me ndriçim, është 15€ pa ndriçim një stërvitje. Janë shuma që deri më tani asnjë klub nuk ka mund t’i bëjë ballë atyre shumave. Dy muaj ka ndodh ,dy klube e kanë ushtruar aktivitetin dhe gjithë të tjerët e kanë ndal aktivitetin e pastaj kur u pa që nuk bënë kështu, u kthy aktiviteti si më herët dhe janë kthy të gjitha klubet dhe kanë vazhdu aktivitetet normalisht si çdo vit tjetër. Laureta e quajti favorozim ose subvencionim. Këtë vit i kemi 300.000€ dhe deri vjet nuk kanë qenë as 100.000€. Klubet kanë shumë shpenzime dhe besoj që të gjithë ne duhet të ndihemi krenar nëse ne i ndihmojmë sado pak që një klub mos të shuhet dhe ti vazhdoj aktivitetet. Nëse na kthehet kundër, kemi me i qëndru sepse kemi marrë përgjegjësi kur e kemi nënshkru atë vendim, mirë apo keq. Unë e konsideroj vetën që deri sot si Drejtori e Kulturës për një vit e pesë muaj që jemi, punojmë si staf dhe i kemi kalu të gjitha me sukses.

**Qëndrim Elshani** - ne e dime që në palestrën sportive “13 Qershori” gjatë kësaj sezoni që ka përfunduar e kanë shfrytëzuar edhe klube të cilat nuk janë të Komunës së Suharekës. A kanë pagu këto klube apo jo? Për deri sa kemi buxhet me i fal disa borgje, si nuk kemi pas buxhet me ngroh palestrën sportive ?

**Lorika Gashi** - po, e kanë shfrytëzuar klubet e jashtme ashtu siq e ka shfrytëzuar edhe Ylli jonë e gjitha klubet tjera palestrën “Sezahir Surroi” dhe të gjitha palestrat tjera në kohën kur ne e kemi pas në ndërtim palestrën tonë. Nuk kanë pagu. Ka pas pak më shumë ngrohje se viteve tjera sepse këtë vit ka pas edhe për stërvitje ngrohje dhe jo vetëm për lojë sikur ka ndodhë viteve të kaluara.

**Flamur Bytyçi** - kur po flasim për rregullore, po kthehem para dy apo tre seancave më herët ku e kemi pas debat edhe me prof. Aziz që ne si anëtar të Kuvendit duhet të nisim dhe ti ndërrojmë disa rregullore që

janë të 2008-tës duke fillu prej statutit të Komunës, rregulloren e palestrës, rregulloren e bursave etj. Kur s'po keni bazë ligjore për me kry punë, ju po kërkon me ndryshu rregulloren. Unë besoj që kur ke ardhë është dasht me ndryshu rregulloren. Kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor për vendimin se a ka bazë ligjore.

**Lorika Gashi** - Flamur, prej 2010-tës nuk është ndryshu asnjë rregullore në Drejtorinë e Kulturës. Kemi fillu dhe sa të mujm me kry punë, i kryejmë.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që ky vendim është i bazur në dy ligjet bazike që ka të bëj me çështjen e miratimeve të të hyrave vetanake. Është ligji për financa të pushtetit lokal neni 2 pragrafi 3 ku thotë: Kuvendi i Komunës dhe zyrtarët e ekzekutivit kanë të drejtë që të menaxhojnë dhe ti ekzekutojnë burimet financiare. Neni 8 lidhur me nenin 21 i kategorizon të hyrat vetanake për të cilat i jep kompetencë dhe mandat këtij Kuvendi që ti caktojë këto tarifa dhe ligji për vet qeverisje lokale neni 40 këtë kompetencë ia jep ekskluzivisht Kuvendit që ti miraton tarifat dhe ngarkesat për të hyrat vetanake të Komunës dhe njëkohësisht është në diskrecionin dhe mandatin e këtij Kuvendi që njëkohësisht ti fal, ti liron të hyrat vetanake aty ku e sheh të nevojshme dhe të domosdoshme. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime. Një sqarim për Albanin dhe pa keqkuptime. Nuk e di a ke ndonjë reklamë apo s'ke por nëse ka dhe përmendet emri i firmës tënde, pa keqkuptim, lind dhe dyshohet që mund të lind konflikt interesi pavarësisht a je drejt për së drejti ti apo e përdor një klub sportiv. Kjo është sa për informatë dhe çështja është e jotja se a tërhiqesh apo jo.

**Alban Berisha** - apsolutisht nuk më mbetet hatri por vetëm e dhashë si vërejtje. Reklama është dhe është prej kur është ndërtu kjo palestër edhe pse nuk kam pas dëshirë me cek. Ne kemi pagu për atë reklamë. Unë i thashë edhe drejtoreshës që me rregullu këtë dhe me shku në formën e duhur ligjore. Vërejtja ime ishte që mos të ceket më kompamia ime këtu sepse pavarësisht bizneseve ose jetës time private, unë këtu jam si asambleist. Për deri sa u diskutu për Delloc dhe kolegja ime e ka ngrit si çështje, ku jam prek unë personalisht dhe unë prap e kam përkrah sepse ashtu është dhe duhet të zgjidhet ai problem.

**Avni Bytyqi** - u përmend rregullorja dhe është e vërtetë që rregullorja është e 2008-tës, mirëpo në konsultim me Kryetarin dhe me Drejtoreshën, mbledhjen e radhës do të vijë kjo rregullore që të shfuqizohet dhe këtë vit kemi në plan të bëjmë plotësim-ndryshimin e rregullores për tarif-ngarkesa dhe shërbimet Komunale dhe në kuadër të asaj rregullore do të rregullojmë çështjen edhe të shfrytëzimit të palestrës sportive.

**Alban Berisha** - është hera e pestë që po iu këshilloj. Nuk është politike por është këshillë profesionale. Ju kisha lut të mos na sillni projekt akt. Një seancë para se ta sillni për miratim, ta sillni si draft dhe ne ti japim vërejtjet dhe këshillat tona. Pavarësisht bindjeve tona, llogaritet që opozita ka me votu gjithmonë kundra por nuk është ashtu sepse edhe ne kemi dëshirë ta japim kontributin tonë. Ne jemi organi që e nxjerrim aktin kurse ne po vim para aktit final vetëm a je po, ose jo. Besoj që dikush prej jush pajtohet me një vlerësim t'imin apo të një kolegu që kjo nuk e ka vendin në këtë rregullore. Mos u ndieni të ofenduar por po e marr si shembull. A pajtoheni edhe ju që nuk e ka vendin në atë rregullore kazino, motel dhe bastore? Nuk e ka vendin dhe më mire që s'kaloj. Kur ti japim ne disa vërejtje, mos e ndëgjoni me veshin politik por ndëgjone me veshin professional. Unë e votoj.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 7.

**18 për, 10 apstenime  
Miratohet pika 7**

**Pika 8. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - është e disata herë që na vje një vendim për bartjen e mjetetve. Kjo tregon që kjo qeverisje nuk po i planifikon mirë projektet kapitale dhe këto mjete po mbesin si sufucit që ju gjithmonë po e mohoni. Vlerën prej 182.779 € mund ta arsyetoni pasi që janë në periudhën e tre mujorit të fundit dhe mund të tejkalohe si të hyra ndërsa vlere prej 304.355 € është vlerë që ju nuk keni pas projekte apo i keni keqklasifikuar ato si viteve tjera, ku vërejtja kryesore e auditorit ka qenë keqklasifikimi. Është shqetësuese se si mendoni ti bartni mjetet në vlerë prej 83.989 € në projektin "Ndërtimi dhe rregulimi i kolektorit në

rrugën Skënderbeu” ku ky projekt e ka vlerën milionëshe.Po ashtu Ministria e infrastrukturës për këtë projekt nuk e ka dhënë ende dritën e gjelbër.A do të thotë që ne prapë kemi me i bartë këto mjete në një projekt tjetër siq janë bartur edhe më herët nga byjqësia në kolektor dhe në fund vit janë shpërnda me aktvendime pa i sjell në Asamble.Ne si VV mendojmë që kjo bartje nuk duhet të kaloj.

**Urim Suka** - jemi duke fol për vendimin për bartje por ju e dini që vendimi për bartje është bërë njëherë por për shkak të atij vendimin të Ministrisë për mos me i dhënë të drejtën me i shfrytëzuar paratë e vitit 2021 që ju kanë tepër,Tash ka ardhë vendimin i ri për tu bartë prap pjesa që po lejohet për vitin 2022.Dua ti them disa fakte me rëndësi.Fakti i parë është ajo që kemi thënë vazhdimisht,që ju kohën e fundit jeni duke u bërë shumë të paafte për ti shpenzuar paratë publike.E para është që 142.000€ iu kanë mbetur suficit që në fillim,e dyta është që tash edhe mbi 400.000€ kanë humb për shka se ju nuk keni mund ti shpenzoni e që i bie që suficiti po shkon drejt 600.000 eurove dhe është mire ta dinë edhe qytetarët,që ju neve për një vlerë shumë më të vogël na keni akuzu.Kjo është ajo që ne e kemi thënë vazhdimisht,një paafte për me implementu projektet e investimeve kapitale ashtu si i keni miratu. 600.000 eurove që kanë humb krejt,ku ja shton edhe paratë që ju i keni pagu duke e shkel ligjin,del që më shumë se 1 milion euro janë keqpërdor nga ky pushtet.Unë dua ti ngris disa dilema rreth vendimit që ju e keni sjell dhe pak a shumë jam me një linjë me Qëndrimin për pjesën te kolektori.Në projekt-vendimin e parë kanë qenë të planifikuara te kolektori në rrugën Skënderbeu edhe 200.000€,në planifikimin e buxhetit janë të planifikuar 290.000€ por këtu në këtë planifikimin që ka ndodh ky shkurtimi janë vetëm 83.000.290.000 dhe 83.000 po japin një shifër jo aq sa është e nevojshme për tu përmbush projekti i kolektorit sepse projekti i kolektorit i afrohet 1 milionëshit.Kur nuk i keni paratë e mjaftueshme për me përmbyll këtë projekt,a mos është rrezik që ju nëse i nisni punimet pak a shumë si keni fillu,a mos është rrezik që ju keni me qel atë teren komplet dhe mos me mujt me përmbyll si projekt dhe me qenë kaos për të gjithë qytetarët aty,për bizneset,për njerëzit që jetojnë aty?Dilema e njejtë është te projekti i ndërtimit dhe sanimit të rrugës Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh.Edhe këtu ka ndodh shkurtimi në krahasim me planifikimin e parë.A keni me përmbush apo jo? Na jepni sqarime që ta dime,por përtej sqarimeve që ju mund ti jepni,kjo që i ka ndodh këtij buxheti,kjo paafte,kjo bartje që e keni sjell,ka qenë e pa pranueshme në fillim,është e pa pranueshme sot dhe ne urojmë që ju ta ndërroni qasjen dhe urojmë që edhe bartjet edhe vendimet tjera t’ia votojmë.Shumicën e vendimeve që ju sillni dhe që u dasht pak përgaditje,shumicën i keni gjithmonë pa përgadit dhe ne detyrohemi gjithmonë me votu kundër për kundër që në realitet edhe bartjen unë po kam dëshirë me votu por e gjitha është e keqplanifikuar dhe për atë ne votem e kemi kundër prap si grup.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 8.

**16 për, 7 kundër**  
**Miratohet pika 8**

### **Pika 9. Pyetje dhe përgjigje;**

**Shefket Kolgeci** - sigurisht edhe juve asambleistëve iu ka ra që muajve të fundit me ndëgju në mediat tona lokale elektronike me një dukuri në Komunën tonë që ka të bëjë me mbi ndërtimet.Prandaj qeveria komunale disa ka fillu me i rrënu e disa jo.Unë kërkoj nga Drejtoria e inspeksionit dhe nga Kryetari që në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë të sjell listen e të gjitha mbindërtimeve që ekzistojnë në Komunën tonë por gjithëashtu duhet ti sjell edhe të gjitha vendimet për rrënimin e tyre.Gjithëashtu duhet ti sjell edhe cilat mbindërtime janë rrënu dhe cilat nuk janë rrënu.Jam në dijeni që janë bërë një apo dy rrënim.

Shqetësimi i qytetarëve personalisht ka ardhë deri te unë dhe thotë që pse mbindërtimi im me u rrënu dhe i komshiut tim jo.Dikujt të ia rrënojmë e komshiut të mos ia rrënojmë të njejtin mbindërtim,unë besoj që nuk është kuti i njejtë për të gjithë.Duhet të jetë vendimi i njejtë për të gjithë.

**Albulena Kokollari** - ashtu si e keni pa edhe nëpër rrjetet sociale,ne kemi fillu me rrënimin e mbindërtimeve të cilat janë të jashtligjshme.Thatë që njërit po dhe komshiut jo.Të gjitha mbindërtimet kanë me u eliminu për të cilat edhe ju jeni të shqetësuar.Për listën e ekzekutimeve,unë mund të jap

përgjegjësi vetëm sa jam unë drejtoreshë dhe mund ti sjell ndërsa për listen e mbindërtimeve flasim me inspektorat dhe e rregullojmë.

**Shefket Kolgeci** - unë nuk jam për ti rrënuar aty për aty sepse dëmtohen ata qytetarë.Thashë:le të vlerësohet në atë moment,në atë vend ku nuk ka rrezik për qytetarët tjerë,dëmtohet stabiliteti i asaj.Le të bëhet një legalizim sepse ju ndihmojmë qytetarëve.Nuk jam për rrënime.Ku ka hapësirë për mos me rrënu edhe unë jam për mos ti rrënuar.

**Albulena Kokollari** - sa për sqarim,tani ne i kemi hartat zonale dhe nuk e lejon të legalizojë një mbindërtim që është i jashtligjshëm.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - çështja që dua të ngris është çështje që e kam ngrit edhe herave të tjera e cila ka të bëjë me raportimin e PZHK-së.Nuk dua të bëhem e përsëritshme dhe aq më pak e bezdisshme por është një obligim ligjor që i takon ekzekutivit në këtë rast për me e sjell në Kuvend raportin mbi zbatimin e PZHK-së.Kjo detyrë është e të gjitha drejtorive dhe sa kam informacion Kryetari veq e ka formu një komision që raporton mbi zbatimin e PZHK-së dhe po kërkoj direkt nga Kryetari dhe jo nga drejtoritë që të bëjnë presion te ky komision në mënyrë pozitive që të sjellin sa më parë raportin mbi zbatimin e PZHK-së në Kuvend. Në njërën prej seancave që e kam pas si diskutim,Drejtori i Urbanizmit ka thënë që nuk është zbatu PZHK-ja.Por edhe nëse nuk është zbatu PZHK-ja,të paktën t'na sillt një fjali se nuk është zbatu PZHK-ja.Pra, raport me shkrim dhe jo raport gojor.Shpresoj që në seancën e radhës,në qershor të jetë raporti si pikë e rendit të ditës.

**Visar Kuçi** - Kryetari me një vendim e ka formu ekipin për monitorimin dhe zbatimin PZHK-së dhe HZK-së ku udhëheqës i ekipit jam unë si Drejtori e Urbanizmit.Ne jemi duke i përgatit dhe për këtë vit do ti përgadisim të gjitha dokumentet që janë duke u punu,duke e zbatu HZK-në dhe PZHK-në.Besoj muajin e 6-shtë e kemi një takim si ekip dhe do ta sjellim raportin për PZHK-në dhe HZK-në.Është fakt që për vitin e kaluar nuk është sjell raporti sepse ekipi u formua në shkur të këtij viti. Po bëhet fjalë për një mbindërtim ku ne si Komunë e kemi rrënu.Pala ka qenë i pajisun me aktvendim për renovim të kulmit dhe është ndoshta i vetmi kulm ku e ka tejkalu lejen ndërtimore por të paktën ka qenë i pajisun.Në mandatin tim ajo leje është lëshu,ajo e ka tejkalu dhe e kemi rrënu.

**Shefket Kolgeci** - unë e barta vetëm shqetësimin e qytetarëve dhe detalet nuk i di.Detalet i dinë drejtoritë.

**Visar Kuçi** - në rastin e parë Drejtoria e Inspeksionit ka qenë duke e monitoru renovimin.E ka tejkalu lejen dhe është rrënu.Në rastin e dytë qytetarët kanë dërgu fotografi të rrënimt të dytë që ka qenë duke e renovu brenda.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - Drejtor,pasi je kryetar i grupit punues që bën monitorimin dhe zbatimin e PZHK-së,ju kisha kërku që me marrë me prioritet dhe të paktën me sjell në seancën e ardhshme zbatimin e PZHK-së për vitin 2022 dhe mandej ju si grup punues vazhdoni me zbatimin e PZHK-së për vitin 2023 dhe zbatimin e HZK-së për vitin 2023.Le të jetë prioritet për shkak se ka 6 seanca që është duke mungu raporti i PZHK-së.

**Kushtrim Kuçi** – Kryetar,shumë lehtë e ke me menaxhu qytetin.Vetëm dëgjoje grupin parlamentar të LDK së dhe beso që zgjidhjet i keni shumë të sigurta.E vlerësoj shumë që ke reagu dhe që ke thënë që për shkak të reagimit të opozitës,për mbindërtimet që biseduam dhe është shumë e qëlluar.Në seancën e kaluar kemi bisedu për stacionin e autobusave dhe po e shoh që një problem që po e shtjellojmë po ka rezultat.Falemderoj dy zyrtarët e inspektoriatit të cilë nga momenti që e kemi analizu problemin e stacionit të autobusave,pothuaj çdo ditë kanë qenë qenë të pranishëm në rrugën Hajdin Berisha dhe kanë bënë denime për të gjithë ata autobusa të cilët nuk janë ndal në stacion dhe kanë pas për qëllim ti ikin tatimeve.Kryetar të falemderoj edhe për aksionin për pastrimin e qytetit,mirëpo e kam cek dhe në një seance që problemi është te qytetarët të cilët nuk e mirëmbajnë ambientin rreth lokaleve të tyre dhe me sa e di Komuna e ka nxjerr një vendim pas të cilit dënohet çdo qytetarë dhe prap përgjegjësia po bie te inspeksioni.Ju sugjeroj që të merreni me këtë.Kryetar,në seancën e kaluar e ke përmend edhe Z.Industriale mirëpo në takimin që keni pas në mandatin e kaluar me bordin e Z.Industriale,investimi ka qenë pothuaj zero, dhe ka pas ankesa që kompania e cila merret me mirëmbajtje shumë rrallë ka shku atje.Këtë mandate po e vërej që është një anë positive ku ke mbjell drunjë dekorativ dhe reklama me bashkëfinancim por ka probleme edhe me kanalizime.Problemi tjetër është edhe shtëpia e kulturës dhe të lus Kryetar që ta marrësh më me përgjegjësi sepse vërtet është tepru.Për themelimin e teatrit ka pas

keqkuptime prej artistave sepse nuk e ke pas fjalën për teatrin atje por e ke pas fjalën për teatrin që e ke kriju këtu. Sikur që kemi artista por nuk kemi shtëpi të kulturës, kemi sportista por nuk kemi fushë sporti, kemi Asamble por s'kemi asambleista. Kryetar, dikur ke dal në lidhje direkte dhe ke premtu që do ta realizosh një stadion kurse në seancën e ardhshme the që s'ka shancë të bëhet stadiumi. Ankesa e klubit të Ballkanit janë vlera prej 7.500 € për reflektor, për të pas mundësi të ushtrojnë pasi të errësohet. Kërkesën që i kam bë zyrës së Kryetarit për shpenzime për media të cilën e ceki edhe Urimi dhe është firma Ballkani grup nga Prishtina. Asgjë s'ka promovu ajo firmë. A do të ishte më e arsyeshme që së bashku me Drejtorinë e Shëndetësisë të bëni një fushatë sensibilizuese për të lajmëruar gratë e Suharekës për mamografinë që është falas. Investimet në qytet janë shumë të vogla. Do të ishte mire të bënit nënparkingje.

**Reshat Selimaj** - Kushtrim, e potencove punën e stacionit. Ne të gjitha shqetësimet çdo here i kemi ngrit aty ku ka pas ngecje por duhet të dish që inspektorët nuk marrin urdhëra as prej teje dhe as prej meje. Duhet të falemderohet drejtoresha që e ka marrë seriozisht këtë punë dhe ti po bie dakord me mua që unë e kam ngrit si shqetësim me vend.

**Liridon Fandaj** - sa leje ndërtimi ke lëshu prej fillimit të mandatit tend dhe a i ke mbikqyr ato leje ndërtimi së bashku me Drejtorinë e inspeksionit? Sa qerdhe publike janë në Komunën tonë dhe cilat janë të licencuara? A e ke menduar ndonjëherë që ka familjet me të ardhura të vogla dhe i kanë nga dy fëmijë e që obligohen ti dërgojnë në qerdhe, ti subvenciononi ose ti lironi nga pagesa?

**Visar Kuçi** - numrin e lejeve saktë nuk e di nga fillimi i mandatit por çdo kusht ndërtimor që e lëshon Drejtoria e Urbanizmit janë të publikuara në faqe të Komunës dhe monitorohen nga USAID, përjashtim për shkak të privatësisë i fshijmë të dhënat personale të palës.

**Albulena kokollari** - ne e mbikqyrim çdo leje ose mos leje të urbanizmit. Ministritë na kanë dhënë shumë lavdata që jemi Komuna e vetme që kemi bashkëpunimin më të mirë në mes urbanizmit dhe inspeksionit.

**Remzi Bajselamni** - Komuna e Suharekës ka një qerdhe publike, qerdhen "Fluturat" me shtatë paralele të ndara në fshatrat më të mëdhenjë të Komunës sonë. Menaxhimin e bën drejtoria e qerdhes dhe e ka rregulloren se si bëhet pagesa për këta fëmijë që shkojnë në qerdhe. Çmimi është shumë i lire dhe në muaj është 30 €. Unë personalisht kam kërku që të bëhet 50 € por nuk ka leju Kryetari.

**Urim Suka** - unë jam i shqetësuar për dy pyetjet që i kam bë dhe nuk kam marrë asnjëherë përgjigje. Pyetja e pare ka qenë për Drejtorinë e Arsimit, për faturat e pa paguara që iu kanë mbet shkollave. Sa janë ato fatura, sa para janë dëmtu shkollat dhe me çka janë pagu ato para? Kurrë s'kam marrë raport. Pyetja e dytë ka qenë për Kryetarin por Kryetari nuk ka qenë këtu dhe Kryesuesi e ka marrë obligim që e interpreton por unë asnjëherë s'kam marrë përgjigje. Pyetja ka qenë për pagesat që janë bërë për "Ballkani info". Portali shkruan që është me seli në Prishtinë dhe poston për Kryetarin dhe gati asnjëherë për Komunën e Suharekës. Paratë paguhen çdo muaj. Po dua ta di se cila është procedura dhe nga u zgjedh ai portal? Pyetje për Drejtorinë e Arsimit: ditë më pare unë e kam vizitu shkollën "Shkëndija" ku kam parë nga afër problemet me të cilat përballet ajo shkollë. Ju në planet tuaja keni planifikuar rrethoja urbane mirëpo fakti që ajo shkollë rrethojat i ka dhe gjendja ishte shumë e kënaqshme. Gjatë vizitës u informova se kjo shkollë është pa izolim dhe gjatë dimrit ambienti është i ftohtë, gjithëashtu problem i madh ishin edhe dëmtimi i dysHEMEVE nëpër klasë. Kur pritet të bëhet izolimi i kësaj shkolle? A keni planifikuar investime në sanimin e dysHEMEVE nëpër dhomat e mësimit? Ju po doni ti qoni 150.000 te rrethojat urbane ndërsa fëmijët nuk po mund të mbajnë mësim aty nga i ftohti. Sipas informatave që unë kam, me 27 shkurt profesori i psikologjisë në gjimnaz është pensionuar mirëpo zëvendësimi i tij nuk ka ndodhur. Si pasojë orët në muajin mars janë humbur ndërsa si pasojë në muajin prill dhe maj orët janë shpërnda tek dy profesorë të tjerë si orë shtesë. Pse nuk është hap konkurs për rekrutimin e profesorit të ri për këtë vend pune sipas procedurave ligjore me qëllim që kur të vje koha e pensionimit të profesorit aktual, veq me qenë i rekrutuar profesori i ri. A jeni në dijeni për dëmin që po i bëni nxënësve me mos veprimin e qëllimshëm tuajin për ta rekrutuar në kohë profesorin e ri? Pyetje për shëndetësinë: Dikur Kryetari për shëndetësinë e Suharekës thoshte se gjendja është më mire se në Francë e në Gjermani. Poashtu premtimi i tij ishte që të gjitha AMF-të do të funksionalizohen por e vërteta është diçka tjetër. Ditë më pare unë i kam vizituar disa nga AMF-të në disa vendbanime. Ajo që konstatova nga vizita ishte se në fshatin Bllacë, Semetisht, Studenqan, Doberdelan, Leshan dhe Nishor, këto qendra ishin

jasht funksionit.Në fshatrat Bllacë,Semetisht dhe Reqan ka një kohë të gjatë që janë të mbyllura ndërsa në fshatrat Doberdelan,Leshan dhe Nishor mungon mjeku dhe qendra mbahet hapur vetëm me infermier.A pritet që këto qendra të funksionalizohen dhe kur do të ndodhë kjo?Si është gjendja me furnizim me materiale shëndetësore-barna sepse ankesat për mungesa elementare janë të mëdha. Kam një shqetësim nga një prononcim të Kryetarit që e kam pa në media lidhur me investimet që kanë për tu bërë në ujësjellës.Aty thotë që për investimet e Bllacës janë nda 200.000€.Është një e pa vërtetë e madhe sepse në buxhetin kur është miratu për ujësjellës janë nda 199.000€ dhe kategoria është për fshatrat Papaz,Sllapuzhan dhe Bllacë.Ato 199.000€ a do ti investosh në Papaz,në Sllapuzhan apo në Bllacë?Nga sa para i ke planifiku me i iverstu në secilin fshat?

**Kryetari** - janë të parapara në buxhet 199,999.99 cent të parapara për shtimin e sasisë së ujit në fshatin Bllacë,Papaz dhe Sllapuzhan.Memorandumi është përgaditë dhe presim që ta vazhdojmë memorandumin me Hireregjionin e kompanisë shtetërore.Në Papaz është ndërtu bazeni i ujit dhe në Sllapuzhan,mirëpo ne si Komunë nuk kemi shapall asnjëherë tender për ujësjellës deri sa është një kompani shtetërore që është përgjegjëse për të.Te Ballkan Info jam duke e zbatu ligjin që e kamë parapa si Kryetar i Komunës.Është edhe Radio Kosova e Lirë.,Radio Vala.Të gjitha ato që kërkojnë,unë e zabtoj ligjin dhe kryej punë si Kryetar i Komunës.Te problem i shëndetësisë,kam thënë dhe prap e them që në Francë me shku duhet të presim 3 orë në emërgjencë pas ores 15:00 dhe njëjtë e ke edhe në SHBA dhe nuk ka si në Suharekë.Ka pas shkëputje për një arsye,pasi që një numër shumë i madh i mjekëve tonë kanë shku në specializim në Prishtinë dhe më duket që me konkursin e fundit plotësohen.Të gjitha qendrat hynë në sistem.

**Urim Suka** - unë të pyeta që 200.000 € në cilat fshatra ke me i qu dhe ti nuk dhe përgjigje.Unë të pyeta se si e ke zgjedh Ballkani Info dhe pse nuk e zgjedhe një tjetër?Nëse një shërbim sipas ligjit duhesh me ja dhënë dikuj çdo muaj,duhet me bë një procedure.Ato 99 € ke të drejtë 1 ose dy here në vit me pagu dhe jo çdo muaj.

**Kryetari** - unë jam duke e zbatu ligjin dhe nëse dyshon,shko dhe më padit.

**Urim Suka** - te shëndetësia the që i ke rekrutu 12 mjek dhe si rezultat i kësaj kemi me I funksionalizu AMF-të që unë i kam ngritë.Prej këtyre 11 mjekëve,8 i ke pas në punë me kontratë.Për deri sa i ke pas,pse nuk i ke dërgu?

**Kryetari** - si t'kam bo drejtor dhe sa kam dasht t'kam majt dhe ku kam dasht t'kam hek.I njeiti rrugëtim është edhe tash.

**Urim Suka** - unë po kërkoj përgjigje për pyetjet dhe ti drejtor nuk më ke bë kurrë.

**Remzi Bajselmani** - nuk e kuptova se në çfarë cilësie ke shku në shkollën"Shkëndija" gjë që më ka bë përshtypje. Më bëri përshtypje edhe fjala "rrethoja urbane",që kurrë se kam ndëgju dhe për here të parë e kam ndëgju prej teje.Në asnjë dokument të drejtorisë së arsimit s'e kam pa.Shkolla Shkëndija është e vërtetë që është në gjendje jo të mirë në infrastrukturë.Ne në 2019 dhe 2020 e kemi bë një projekt,e kemi fut në projekt dhe ky projekt është nënshkruar në zyrën e Kryetarit me Qeverinë e Kosov.Ka qenë rreth 600.000€ por për fat projekti nuk është realizu për shkak të ndërrimit të qeverive.Vetëm në atë shkollë u parapa të investohen 300.000€.Prap e kemi dërgu këtë vit sepse qeveria prap e ka funksionalizu ekipin dhe jemi në process të pritjes për realizim.Te gjimnazi ka qenë ish pedagogu i shkollës duke i mbajtë orët e psikologjisë ,norma prej 12 orëve dhe në konsultim me drejtorinë e shkollës janë zotu që kanë kuadër brenda për brenda për ti mbajtë orët dhe tash ne jemi duke përdor politikë që të mos shtojmë numra sepse ka tepriçë nëpër shkolla dhe është edhe rekomandim i Ministrisë.Ne do ta rirregullojmë dhe në qershor grumbullohen të gjitha të dhënat e shkollave,dhe konkursi shpallet gjatë muajit korrik për të filluar në muajin shtator vitin e ri mësimor.

**Urim Suka** - unë gjithmonë kam pas respekt për drejtorin por kam nis ta humb respektin.Po më drejtohet se me çfarë cilësie ti ke shku në shkollën Shkëndija!Kur të dua unë shkoj në shkollën Shkëndija dhe duhet ta dish se në çfarë cilësie kam shku. Kam shku spese jam asambleist,i zgjedhur i njerëzve.Ti nuk duhet të shqetësohesh se në çfarë cilësie kam shku por ti duhet të shqetësohesh që fëmijët kanë ftohtë në atë shkollë.Te gjimnazi i ike përgjegjës.Ata që i mbajnë ato orë,e kanë normën e plotë dhe janë duke mbajtë orë shtesë dhe ajo është gabim.Të lutem drejtor mos e përdor logjikën të më frigosh.

**Remzi Bajselmani** - Urim, të lutem ke kujdes! Ti je një mësues klasor dhe je duke e lënë një klasë ka sa muaj pa mësuar. Është puna primare e jotja dhe je duke e lënë një kalsë prej 20 nxënësve atje dhe sukset i ke të dobëta në atë klasë sepse kështu janë informatat prej shkollës.

**Kryesuesi** - ajo është e përcaktuar me ligj.

**Elmaze Bytyqi** - cilat janë masat e marra nga komisioni për mbikqyrjen e zbatimit të HZK-së? A keni probleme gjatë zbatimit në teren dhe nëse po, cilat janë ato probleme?

**Visar Kuçi** - në përgjithësi mire është duke shkuar puna. Edhe zyrtarë e kanë më të lehtë, edhe kur lëshojnë kushte ndërtimore dhe kur ta hartojnë një dokument. Për ekipin është fakt që jemi një vit me vonesë për hartimin e hartës dhe rrgullorja e thotë që kur të bëhet ekipi për HZK, duhet të bëhet edhe e PZHK-së. Por do ta bëjmë edhe atë sepse e kemi obligim.

**Dardan Berisha** - nuk është mirë këtë Kuvend me shëndrru në cirk sepse u ngrit Kushtrimi dhe po bën cirqe dhe ka gjet frymëzim ndoshta prej VV-së. Gjithëashtu na fyru neve asambleistave dhe nuk reagon ata si reagojnë zakonisht. Replikën e ka një minutë dhe një herë. Për një pikë të rendit të ditës nuk mund ti dëgjojmë 4 orë kot. Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, të cilën pyetje e kam bë edhe një herë. 1. Vendosija e pahive mbrojtëse në segmentin e rrugës që lidh Z. Industriale me autostradën. Ke thënë që është projekt i ministrisë por kjo nuk është projekt i ministrisë. Keni bërë kërkesë në ministri dhe ministria nuk iu ka kthyer positive dhe besoj që duhet të bëhet një zgjidhje. 2. Kur do të fillojë shtesa e dytë e asfaltit në fshatin Greikoc? 3. Për projekt-vendimin e themelimit të njejsisë Eko Theranda për sanimin e rrugëve, deri ku ka shkuar procedura? A nuk po e lejon Ministria apo ku qëndron problemi? Pyetje për Drejtorin e Urbanizimit: ka qenë pyetje dhe më herët për emërtimin e rrugëve të pa emëtuara. Deri ku ka shkuar ky proces? Pyetje për Drejtorin e Kulturës dhe Sportit: Pse nuk ka përfunduar projekti i terrenit sportiv në Gjinoc? Pyetje për Drejtorin e Arsimit: Kur do të hapet qerdhja e re e qytetit afër tregut javor?

**Alban Berisha** - i drejtohet Dardanit dhe thotë që pavarësisht mënyrës së diskutimit të z. Suka dhe Kushtrimit, ne e kemi një Kryesues Kuvendi që është i votuar prej juve por zyrtarisht është edhe shefi ynë. Janë disa rrgullore dhe norma që e rregullojnë punën e funksionimit të Asamblesë Komonale dhe është detyrë e kryesuesit që nëse e tejkalon dikush minutazhin, është kompetencë e Kryesuesit t'ia ndalojë ose t'ia lejojë. Nëse ka gjuhë jo adekuata, prap e them që është Kryesuesi që është kompetent dhe është i thirrur ti rregullojë këto çështje por jo ne ndaj njëri tjetrit. Alban Berisha nuk pajtohet me fjalimin e Dradanit i cili tha se nuk mund ti dëgjoj 4 orë kot dhe i kërkoi që të tërhiqet sepse thotë që ne kemi një elektorat që na ka votu dhe do të na votojë prapë dhe është e drejtë e tyre nëse na votojnë ose jo.

**Kryesuesi** - Alban dhe të gjithë ju kolegë. Ne jemi kolegë dhe jemi të barabartë dhe është e vërtetë që unë kam bërë pak lëshime por kjo nuk do të ndodh më sepse në seancën e radhës e kemi të drejtën e replikës vetëm një herë për një pikë të rendit të ditës siq parashihet edhe me rregulloren e punës së Kuvendit. Kryesuesi lexon rregulloren e punës së Asamblesë të miratuar më 29.12.2008.

**Dardan Berisha** - këtë vendim tëndin e kemi prit dhe të kam thënë shumë herë, pikërisht për mos me ardhë në këtë situatë. Dardan Berisha nuk pajtohet me fjalimin e Albanit dhe thotë që nuk tërhiqet nga fjalët që tha.

**Enver Shabani** - Sa i përket pyetjes për rrugën nga autostrada që na shpie te Z. Industriale, toka është e shpronësuar nga ministria, ndërtimin e asaj rruge e ka bërë ministria dhe është e vërtetë që ne e shfrytëzojmë si Suharekas dhe gjithëashtu është shqetësuese edhe për ne për vendosjen e pahive mbrojtëse. Jemi në përpjekje dhe kemi bërë një kërkesë në ministri dhe shpresoj që kjo të rregullohet deri në shtator. Lidhur me asfaltin në fshatin Greikoc, është projekt i ministrisë. Sa i përket pyetjes së tretë, ka dhjetë ditë që ne e kemi kthyer një email në ministri, ku kanë kërkuar nga ne dhe që ne e kemi formuar organogramin për një ndërmarrje të mundshme Komonale lokale. Kemi nda një buxhet dhe kemi bërë një përshkrim të mirë dhe po presim një përgjigje pozitive nga ministria.

**Visar Kuçi** - sa i përket emërtimit të rrugëve të reja, një ekip është duke u marrë bashkë me agjencionin për emërimin e rrugëve dhe shumë shpejt kur të mblidhen të dhënat, ne do ti sjellim në Asamble dhe do ta formojmë dhe komisionin për emërimin e rrugëve të reja. Drejtori tutje jep sqarime.

**Lorika Gashi** - në fushën në Gjinoc janë ndal punimet për shkak të motit. Drejtoresha tutje jep sqarime.

**Dardan Berisha** - ndoshta jam gabim por në takim që kam pas me operatorin që është duke e kryer punën, ju nuk keni nda mjete sepse projekti është deviju aty.



**Lorika Gashi** - mjetet janë por kur ta kryen punën operatori ekonomikë mjetet do të lëshohen.

**Dardan Berisha** - janë zgjeru fushat.

**Lorika Gashi** - e vërtetë por e kemi hap dhe pjesën për punë shtesë I cili nuk ka apliku në atë kohë dhe ajo nuk është në përgjegjësinë time por puna do të kryhet.

**Remzi Bajselmani** - sa i përket qerdhes,edhe ne jemi të shqetësuar sepse para një viti ka qenë në këtë gjendje në të cilën është thujse sot.Ne vazhdimisht kemi kërkesë në Ministri të Arsimit për tu funksionalizu sepse projektet që po realizon ministria,ne si komunë nuk kemi qasje në asnjë formë.Problemi është që aty nuk është bërë inventarizimi I qerdhes dhe lënda ka shku prap në OSHP dhe është premtu që do të kryhet deri në maj.Jemi me shpresë që për shtator të përgaditemi.

**Flamur Bytyçi** - kërkesa ime e parë është që ne ta ruajmë gjuhën ndaj njëri tjetrit.Pyetje për Drejtorin e Arsimit:pashë që ka filluar shpërndarja e shujtave për nxënës dhe dua ta di se prej cilës klasë jepen këto shujta.A kanë fillu edhe parafillorët apo jo?Nëse s'ka fillu,a kemi mundësi të ndajmë buxhet edhe për parafillorët?Edhe unë ndaj të njëjtin shqetësim me Dardanin sa i përket qerdhes që nuk po funksionalizohet.Në qerdhen aktuale janë afërsisht 40 nxënës me një klasë dhe është shqetësuese për mua dhe prindërit.Janë rreth 150 kërkesa për ti sjell fëmijët në kopësht dhe thoni që nuk ka vend.A e keni mendu një zgjidhje për këtë çështje.Pyetje për Drejtorinë e shërbimeve Publike:është i planifikuar Ndërtimi dhe rregullimi i rrugës"Adem Shabani" në Reshtan por ajo rrugë është shtruar.Te rruga "Zija Prishtina" keni planifiku me shtru anësore por ajo rrugë nuk ka vend për anësore.Te puna e gërmimit e keni parapa 1.20 metër të bëni gërmim.A doni të hapni pus aty apo doni të shtroni rrugë?

**Remzi Bajselmani** - gati një muaj ka fillu shpërndarja e kifleve dhe buxheti i ndarë është prej Ministrisë së Arsimit.Në ligjin për arsimin parauniversitar,ende parafillorët nuk janë kategori e obligueshme.Tani është në udhëzimin administrative me ligj dhe do të votohet për të hyrë në ligj.Furnizimi bëhet prej klasës së parë deri në klasë të pestë.Qarkorja buxhetore që ka ardhë nuk e parasheh për vitin e ardhëm.Te qerdhja e diskutuam dhe janë afërsisht 80 fëmijë dhe mësueset i shpërndajnë nëpër grupe.Tani ka fillu regjistrimi sepse ka shumë kërkesa.

**Flamur Bytyçi** - ju po thoni që ka buxhet deri në fund të vitit për shpërndarje të kifleve,a mundemi ne si Komunë me nda një pjesë dhe me i subvencionu këto çështje?

**Remzi Bajselmani** - nuk e kemi mendu por do të ishte mirë ti furnizojmë të gjithë,deri në klasë të nëntë por kaq është nda buxheti dhe është prej ministrisë.

**Enver Shabani** - është shpall tenderi me atë emër që the edhe pse rruga është rregullu vitin e kaluar.Pse po përsëriten emrat?Vitin e kaluar kanë tepër para nga buxheti i Reshatnit dhe u shpall faza e dytë.Në fazën e dytë janë rregullu rrugë që kanë qenë të planifikuara për vitin 2023 dhe rruga "Adem Shabani"është përfunduar.Sa i përket rrugës "Zija Prishtina",unë nuk e di sepse dikush tjetër i bën paramasat.Sigurisht është gabim teknik sepse nuk ka gërmime 1.20 m.

**Flamur Bytyçi** - nëse operatori ekonomik aplikon,a ka me shtru atë rrugë apo vetëm ka me i marrë paratë?Besoj që kjo nuk qëndron.

**Enver Shabani** - nëse është gabim teknikin,e vlerëson menaxheri.

**Saranda Bajraktari** - personalisht u ndieva keq prej këtij kreativiteti të Kushtrimit sepse edhe ne si asambleist punojmë por ndoshta rolet tona dallojnë.Unë nuk jam e prirur me bë zhurmë dhe besoj që po punojmë mjaftueshëm për qytetarë.Unë mendoj që edhe brenda grupit tonë ka mendime pro,ka kundër,ka apstenime dhe nuk shkon gjithëçka si po mendoni ju. Më duhet një përgjigje prej zyrtarit ligjor.Është e vërtetë që ne si mësime po na bie me mungu në raste specifike e sidomos në seanca.E di që ekziston një nen specifik që neve na justifikon mungesat tona.A është e ligjshme që ne vazhdimisht me pas presione prej drejtorave të shkollës për mungesa të paarsyeshme dhe thonë që do të ndëshkoheni në mungesë në pagë.Më duhet edhe mendimi i Drejtorit të Arsimit por edhe i zyrtarit ligjor.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që neni 39 pika 5 thotë: kur do herë që anëtari i Kuvendit është i ftuar për një seancë apo për një aktivitet e që ndërlidhet me punën e Kuvendit, e ka të garantuar mungesën nga vendi i punës dhe askush nuk guxon t'ia cenon këtë të drejtë dhe askush nuk guxon t'ia mohon të drejtën për të marrë pjesë në Kuvend dhe t'ia ndaloj pagën apo meditetjen për punën që vje në Kuvend.Edhe për seanca të Kuvendit,edhe për seanca të KPF-së dhe për seanca të Komitetit për Komunitete por pse jo edhe për aktivitetet të cilat ndërlidhen me punën e Kuvendit.

**Saranda Bajraktari** - për deri sa mungesat na bëhen neve të paarsyeshme, Drejtori i Arsimit e ka obligim ti njoftoj drejtorat e shkollave.

**Selman Kolgeci** më vjen keq për nivelin e debatit që po e bëjmë këtu dhe në mungesë të argumenteve të përgjigjeve edhe prej Kryetarit dhe prej Drejtorit të Arsimit, kanë tentu me sulmu individualisht Urimin. Ne jemi opozitë, do t'ju mbikqyrim juve, nuk gëzohemi kur bëni gabime por ato gabime jemi të detyruar ti themi. Kam një shqetësim timin dhe të gjithë qytetarëve. Është çështja e qenve endacak pa përkujdesje e cila po paraqet rrezik serioz për qytetarët në përgjithësi dhe fëmijët në veçanti. Përtej rrezikut të lartpërmendur paraqesin rrezik edhe të përhapjes së ndonjë pandemie sepse nuk dihet nëse janë të vaksinuar apo të trajtuar kundër sëmundjeve. Edhe pse ndërtimi i strehimores, strehimi, mbajtja dhe ushqyerja e qenve mund të kërkoj një kosto të konsiderueshme, kur është në pyetje shëndeti dhe siguria e qytetarëve, pa dyshim që arsyetohet secili investim. Propozoj që së bashku me ekspertët e veterinarisë, ekspertët të fushës së ambientit, organizatat për mbrojtjen e kafshëve dhe grupet e ekspertëve apo institucioneve përgjegjëse të shikohet mundësia e ndërtimit të një strehimore për qentë endacak dhe qentë pa pronar. Pyetja tjetër është për Kryesuesin. Kuvendi është aksionar I stacionit të autobusave dhe ju duhet të jeni në dijeni për dy konkurset që janë shpall në stacion. Në konkursin e parë janë shpall dy vende të lira dhe në konkursin e dytë është shpall një vend i lirë. Në konkursin e parë kanë konkuruar disa persona dhe në konkursin e dytë nuk është paraqit asnjë I interesuar. Si rrjedhojë konkursi I dytë është dasht të anulohet por paradoksi qëndron se si janë pranuar tre persona në konkursin që janë thirrë vetëm dy. Kërkoj sqarime nga ju dhe nga zyryari ligjor. Pyetja tjetër është për Kryetarin. Kemi pa nëpër media që janë nda një pjesë e konsiderueshme e mjeteve për vazhdimin e sheshit. Më intreson të di se a do të vazhdojë projekti i sheshit me projektin që është në fuqi? Nëse po, dua ti them Visarit se ai project duhet të bie poshtë për shkak se është ndërru destinimi i atij projekti. Qështja tjetër të cilin e ngriti Flamuri, për sasi të nëpër paramasë. Nuk është vetëm një paramasë, janë të gjitha paramasat me sasi të fryme. Kjo është si pasojë e fillimit të procedurave të prokurimit publik pa projekte. E kemi ngrit disa here por është e gjetur edhe e auditorit. Ju lutem drejtor të angazhoheni dhe ti kontrolloni paramasat sepse po rrezikohen zyrtarët.

**Ardian Kotorri** vërtetë është një shqetësim I madh trajtimi I qenve endacak si në Suharekë po ashtu edhe në gjithë Kosovën por megjithëatë janë disa lëvizje të mira që pritet të bëhen prej Ministrisë së Bujqësisë. Të planifikuara janë rreth 8 milion euro për gjithë Kosovën. Ne si procedure e kemi nis rreth 20.000 € trajtimin e qenve endacak, shpresoj të na shkoj mire. Sa i përket asaj që thatë për ndërtimin e një qendre të trajtimit të tillë, ne jemi këtu dhe pse jo me miqt me pa si mundësi. Besoj që edhe Kryetari do t'na përkrah por forma se si të funksionojë pastaj. Përndryshe është shumë e nevojshme.

**Kryesuesi** sa i përket çështjes së dytë, unë mendoj që është çështje shqetësuese. Unë me datë 17.05. iu kam drejtuar me një shkresë komisionit të aksionerëve ku kam kërku nga komisioni të përpiloj një raport në mënyrë të detajuar se si ka rrjedh procedura e rekrutimit për tre anëtarët e bordit. Këtë e kam bërë në këtë datë për arsye se e kam prit përgjigjen nga antikorrupsioni I cili ka zgjat rreth 6 muaj deri sa e ka kthyer një përgjigje. Antikorrupsioni e ka trajtuar çështjen vetëm në aspektin administrative ku thotë që nuk ka konflikt interes. Sipas raportit të anëtarëve të komisionit me datë 21.09.2022 është hap konkursi për dy pozita kurse me datë 04.11.2022 është hap prapë një konkurs për një pozitë. Në konkursin e parë kanë aplikuar 6 kandidatë kurse në konkursin e dytë nuk ka pas asnjë aplikues dhe komisioni I ka përzgjedh tre anëtar të bordit. Besoj që do ta bëjmë një bashkëpunim dhe ta sjellim në seancën e radhës si pike të rendit të ditës dhe do t'ja bashkangjesim edhe raportin që ju të njoftoheni se si ka rrjedh procedura. Sipas informacioneve rasti është duke u trajtuar në prokurori. Sa i përket komisionit, këtu është cek që komisioni ka punuar me dy anëtar. Ia jap fjalën zyrtarit ligjor për sqarime.

**Avni Bytyqi** si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që për të gjitha punët dhe aktivitetet që komisioni komunal I aksionerëve bën në emër të Kuvendit, komisioni ka për obligim që ti raportojë Kuvendit. Të çështja se a kanë pas të drejtë dy anëtarët e komisionit të vazhdojnë punën tutje, të paraqitja e konfliktit të interesit që ka qenë njëri nga anëtarët e komisionit, këtë çështje e rregullojnë dy ligje bazike. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ligji për procedurën e përgjithshme administrative. Zyrtari ligjor lexon ligjet dhe tutje jep sqarimet e nevojshme.

**Selman Kolgeci** me këto informacione që na dha zyrtari ligjor, I bie që ai konkurs duhet të anulohet dhe të përsëritet.

**Visar Kuçi** pjesa e sheshit është afër 7 loto dhe është bërë edhe projektimi. Unë vet kam kërku që të vijë projektuesi tash kur të fillojmë pjesën tjetër prej urës së madhe deri te ura e vogël dhe me mjetet që I kemi unë besoj që do ta vazhdojmë edhe pjesën përpjetë sepse janë 1.500.000 të parapara. Nuk fillojmë pa miratimin e projektuesit.

**Selman Kolgeci** pjesa e sheshit është e devijuar prej projektit dhe ideja ishte se a do të vazhdojmë me atë projekt. Si e kemi ekzekutu në sheshin pa projekt?

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj